

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji i përbërë; nga gjyqtarët: Gani Avdiu Kryesues, Mediha Jusufi e Frosina Sulejmani, - anëtarë, (më tej kolegji) në kontestin e paditëses E.R. nga Peja, e përfaqësuar nga av. H.N., në Pejë, kundër të paditurës Banka Kombëtare Tregtare B.K.T Sh.A Dega Kosovë, me seli në Prishtinë-Njësia punuese “Teuta”, e përfaqësuar nga J.H. nga Prishtina, për kthim në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.379/2014 të dt.29.01.2015, pas mbajtjes së seancës së kolegjit, me datë 05.07.2017 jep:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të paditurës Banka Kombëtare Tregtare B.K.T Sh. A. Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë-Njësia punuese “Teuta” në Pejë dhe **Vërtetohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.379/2014 i dt.29.01.2015, me përjashtim të vendimit për kamatëvonesën i cili **ndryshohet** dhe gjykohet si vijon: me kamatëvonesë e cila rrjedhë nga data 29.01.2015 e deri në pagesën definitive të borxhit.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin C.nr.379/2014 të dt.29.01.2015, ka vendosur si vijon:

“Aprovohet vendimi i Komitetit disiplinor i të paditurës Banka Kombëtare Tregtare BKT në Prishtinë, Nr.700/1970, dt. 31.03.2014, me të cilin paditëses i ndërpritet kontrata e punës përfundimisht me datë 01.04.2014, si i kundërligjshme, dhe Detyrohet e paditura Banka Kombëtare Tregtar B.K.T SHA Dega Kosovë, me seli në Prishtinë-Njësia punuese “Teuta” në Pejë, që paditësen ta kthejë në vendin e saj të mëparshëm të punës-arkëtare në njësinë, “Teuta”, në Pejë, si dhe në emër të kompensimit të dëmit material nga marrëdhënia e punës për shkak të mos pagesës së pagave mujore për periudhën kohore prej 01.04.2014 deri 31.10.2014 t’ia paguaj shumën prej 2.168.06 euro, (dy mijë e një qind e gjashtëdhjetë e tetë euro e gjashtë centë), sipas normës së interesit prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe Detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 1.035.00 euro (njëmijë e tridhjetë e pesë euro) të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.”

Kundër këtij aktgjykimi, përfaqësuesi i të paditurës F.SH., më datën 17.12.2012, ka paraqitur një ankesë, me të cilën kanë kërkuar që aktgjykimi ankimor

të ndryshohet, ashtu që të refuzohet kërkesëpapia e paditësit ose aktgjykimi i shkallës së parë të prishet dhe çështja t'i kthehet në procedim të serishëm të njëjtës gjykatë të shkallës së parë, duke parashtruar këto shkaqe: Shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Përfaqësuesi i paditëses është përgjigjur në ankesë.

Kompetenca: Gjykata e Apelit, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare vlerësoi se ka juridiksion për procedim dhe vendimmarrje në këtë çështje juridike, duke u bazuar në nenet 17, 18 e 19 të Ligjit për Gjykatat, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 79/2010).

Vlerësimi formal i ankesës: Nga shkresat e lëndës rezulton se ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë është lejueshme, është paraqitur brenda afatit ligjor, ajo, përmban elementet e parapara me ligj, si dhe është paraqitur për shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi i shkallës së parë.

Kolegji, vlerëson se ankesa i përmbush kërkesat ligjore nga nenet 176, 178 dhe 181 të Ligjit për Procedurën Kontestimore i Kosovës nr.03/L-006 (më tej LPK) dhe përfaqëson mjet të rregullt juridik.

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.38/2008) më teje LPK, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë si dhe, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore në këtë çështje juridike nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje tjera të cekura në ankesë e që do të ishin në ndikim në vendimmarrje të ligjshme dhe të drejtë në këtë çështje juridike.

Nga shkresat në dosje rezulton se paditësja E.R., përmes përfaqësuesit të saj av. H.N. me dt. 05.05.2014, kishte paraqitur një padi në Gjykatën Themelore në Pejë, kundër të paditurës Banka Kombëtare Tregtare, Njësia punuese në Pejë, me kërkesë për anulimin e vendimit të komitetit disiplinor të paditurës BKT, nr.700/1990 i dt. 04.04.2014, dhe 7932 i dt. 16.04.2014, detyrohet e paditura që paditësen ta kthej në vendin e punës si dhe t'ia paguaj pagat mujore nga data 01.04.2014 deri me 31.10.2014, me arsyetim se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i kundërligjshëm, përkatësisht në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 70 e 72 të Ligjit të Punës.

Në mbështetje të kësaj padisë, paditësja ka bashkangjitur kontratën e punës së dt. 01.07.2011, si dhe vendimet, anulimin e të cilave e ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetim se vendimet e të paditurës janë të bazuara në ligj si dhe në aktin e brendshëm të punëdhënësit duke propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa themeltë.

Gjykata e shkallës së parë kishte marr provat e përshkruara në arsyetimin e aktgjykimit ankimor dhe kishte konstatuar gjendjen faktike si vijon: Se paditësja ishte e punësuar te punëdhënësi sipas kontratës të lidhur në formë të shkruar me dt. 01.07.2011, në kohë të pacaktuar si arkëtare për transaksionet në kesh, se asaj me vendimin e komitetit disiplinor nr.700/1970 të dt. 31.03.2014, i ishte ndërprerë kontrata e punës nga data 01.04.2014, me arsyetim se ka kryer transaksione fiktive, pa identifikuar datën e kryerjes së veprimit të tillë.

Kundër këtij vendimi-njoftimi (i cili nuk përmbante udhëzim juridik për të drejtën e ankesës), paditësja kishte paraqitur një ankesë organit për shqyrtimin e ankesave. I njëjti organ i të paditurës, pra Komiteti disiplinor me vendimin 7932 të dt. 15.04.2014, kishte refuzuar ankesën e palës paditëse, duke lënë në fuqi vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Fakt kontestues në mes të palëve procedurale ishte se punëdhënësi përkatësisht tani e paditura a ka zbatuar procedurë ligjore me rastin e vendimmarrjes për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ndaj paditëses.

Gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se e paditura nuk ka zbatuar procedurë ligjore, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 70 par.3 dhe nenit 72 par.2 të Ligjit të Punës.

Në bazë të një gjendje të këtillë të çështjes, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, me arsyetim se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës pa iu dhënë mundësia që të deklarohet të organi kompetent i punëdhënësit, pa u përmbushë kushtet ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, si dhe duke vendosur nga i njëjti organ – Komiteti disiplinor i cili kishte dhënë njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe kishte vendosur gjithashtu lidhur me ankesën.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, të shprehur në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, kolegji e vlerëson të ligjshëm dhe të drejtë, sepse deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes në shkallë të parë, e as në procedurë sipas ankesës, e paditura nuk provoi se Bordi i drejtorëve të BKT-së, me vendim të veçantë, **ka themeluar komitetin disiplinor duke përcaktuar paraprakisht: qëllimin, përgjegjësitë dhe procedurat që do të ndiqen nga ky komitet me rastin e zbatimit të procedurës disiplinore,** ashtu siç është përcaktuar me nenin 12.06 pika 8 të Manualit të politikave dhe procedurave të burimeve njerëzore të BKT-së dega në Kosovë i dt. 01.11.2012.

E paditura nuk provoi se paditëses në këtë rast i është ndërprerë marrëdhënia e punës në pajtim me aktin e brendshëm të punëdhënësit, kontratën e punës dhe Ligjin e Punës, sepse në vendimet përkatëse nuk ekziston konfirmimi se paditëses i është dhënë përshkrimi në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të

përcaktuar kohor brenda të cilit ajo duhet ta përmirësoj performancën, pra se është zbatuar neni 12.1 i Aktit të brendshëm të punëdhënësit, lidhur me shkallshmërinë e masave disiplinore, duke filluar nga vërejtja me gojë, vërejtja me shkrim, ulja në pozitë, por është zbatuar masa më e ashpër, ndërprerje e marrëdhënies së punës pa zbatuar procedurë të rregullt disiplinore në përputhje me Ligjin e Punës dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit, ndërsa ndaj punëtorëve tjerë ky rregull ishte respektuar gjë që bie ndeshë me nenin 5 të LP.

Në shkresat e lëndës nuk ka prova se paditësja i është nënshtruar trajnimeve adekuate, në përputhje me përgjegjësitë e saj që dalin nga vendi i punës, nuk është konstatuar se çfarë dëmi material ka pësuar e paditura si pasojë e shkeljes së pretenduar të detyrave të punës nga ana e paditëses, kur kishte ndodhur rasti, pra nuk përshkruhet data e shkeljes disiplinore, kështu vendimet e të paditurës nuk përmbajnë arsyetim adekuat dhe nuk dëshmojnë së janë rezultat i një procedure ligjore disiplinore, pra ato përfaqësojnë vendime arbitrare. Paditëses nuk i është dhënë mundësi që të paraqes mbrojtjen e saj të organi kompetent i punëdhënësit.

Sa i përket vendimit për kamatëvonesën ai është ndryshuar në përputhje me qëndrimet juridike të Gjykatës supreme të Kosovës, ku është përcaktuar së kamatëvonesa për detyrimet monetare rrjedh nga data e denjës së aktgjykimit në shkallë të parë e që në këtë rast është dt. 29.01.2015, e deri në pagesën definitive të borxhit.

Paditëses i takon e drejta në kompensim të dëmit si pasojë e ndërprerjes së kundërligjshme të marrëdhënies së punës, e duke u bazuar në nenin 80.1.2 të Ligjit të Punës, sepse e paditura nuk provoi së dëmi ndaj paditëses është shkaktuar pa fajin e të paditurës edhe pse e kishte barrën e provës, ndërsa lartësia e dëmit ishte përcaktuar, duke marr për bazë vlerësimin e ekspertit kompetent, si dhe provave tjera relevante dhe të besueshme.

Më sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë krijuar kushtet ligjore nga nenet 200 e 201 të LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
CA.nr.933/2015 dt. 05.07.2017

Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari,
Gani Avdiu